



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 224

Tiranë – E hënë, 28 dhjetor 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 107/2015, datë 17.12.2015	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 96/2014, “Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë”, të ndryshuar..... 14623
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1034, datë 16.12.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 658, datë 26.9.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë”..... 14623
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1037, datë 16.12.2015	Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civilë, për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë..... 14624
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1038, datë 16.12.2015	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Agim Gjonçaj..... 14627
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1039, datë 16.12.2015	Për përcaktimin e procedurave për emetimin, prodhimin, përdorimin dhe tregtimin e pullës postare shqiptare..... 14627
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1040, datë 16.12.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugëve të bllokut 59, që kufizohet nga bulevardi “Bajram Curri”, rruga “Ali Demi” dhe rruga e “Planit rregullues”, në Bashkinë e Tiranës..... 14633
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1041, datë 16.12.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i infrastrukturës së bllokut 61, që kufizohet nga rruga “Qemal Stafa” dhe rruga e “Planit rregullues”, si dhe “Ndërtimi dhe mobilimi urban i sipërfaqeve të zonës 61/1”, në Bashkinë e Tiranës..... 14634
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1042, datë 16.12.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Ndërtimi i linjës së re të ujësjellësit të Durrësit”..... 14635

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1043, datë 16.12.2015	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar.....	14638
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1044, datë 16.12.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës, “Mbi reciprocitetin e godinave ku akomodohen përfaqësia diplomatike e Republikës së Shqipërisë, në Pekin, dhe përfaqësia diplomatike e Republikës Popullore të Kinës, në Tiranë”, nënshkruar më 10.4.1960.....	14638



VENDIM
Nr. 107/2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 96/2014 “PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR REFORMËN NË SISTEMIN E DREJTËSISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës, të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit dhe pikës V të vendimit të Kuvendit nr. 96/2014, me kërkesën e Kryetarit të Komisionit të Posaçëm për Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 96/2014 “Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

I. Në pikën V, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“V. Komisioni i Posaçëm do të zhvillojë veprimtarinë e tij në një afat kohor 20-mujor.”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 17.12.2015

VENDIM
Nr. 1034, datë 16.12.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 658, DATË 26.9.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR VLERËSIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në nenin 6, të aneksit 1, të vendimit nr. 658, datë 26.9.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Pika 1 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“1. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, brenda datës 31 mars të çdo viti, përpunon të dhënat e vitit paraardhës, të dërguara zyrtarisht nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, duke i grupuar ato sipas zonave kadastrale, nënndarjes brenda zonës apo bashkimeve të dy apo më shumë zonave kadastrale, për qëllim të përllogaritjes së vlerës së pasurive të paluajtshme, sipas llojit të pasurisë, ndarjes dhe nënndarjeve të saj, dhe i propozon ministrit të Drejtësisë vijimin e procedurave për miratimin e tyre nga Këshilli i Ministrave.”.

2. Pika 4 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“4. a) Në rast se për një zonë kadastrale, nënndarje apo bashkim të tyre, mungojnë transaksionet për një ndarje apo nënndarje të llojit të pasurisë së paluajtshme, atëherë përcaktimi i vlerës për këto zona do të bëhet mbi bazën e metodës indirekte, duke i grupuar kontratat e shitjes në një nivel më të afërt, sipas kësaj radhe: fshat, qytet, bashki, qark, për atë grup të llojit të pronës.

b) Në rast se për një zonë kadastrale, nënndarje apo bashkim të tyre nuk arrihet të përcaktohet vlerë, edhe pas përpunimit të të dhënave mbi bazën e metodës indirekte, sipas përcaktimit të bërë në shkronjën “a”, atëherë vlera e pasurisë së paluajtshme për atë zonë kadastrale do të jetë vlera përkatëse, e përcaktuar në vendimin paraardhës të Këshillit të Ministrave.”.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 1037, datë 16.12.2015****PËR PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË
NËPUNËSVE CIVILË, PËR PËRFITIMIN
DHE PËRDITËSIMIN E NJOHURIVE
SHITESË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 1/1, të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**KREU I****PARIME TË PËRGJITHSHME**

1. Procesi i përfitimit dhe përditësimit të njohurive shtesë synon aftësimin e nëpunësve civilë dhe pajisjen e tyre me njohuritë shtesë të nevojshme, sipas funksioneve dhe fushës ku ata veprojnë, me qëllim ngritjen e cilësisë së shërbimeve dhe të punës në institucionet e administratës publike, pjesë e shërbimit civil.

2. Ky proces përfshin testimin paraprak dhe, kur është e nevojshme, trajnimin e nëpunësve civilë për njohuritë e reja që prekin fushën e tyre. Në përfundim të trajnimit bëhet testimi me shkrim dhe intervistimi i tyre me gojë, në lidhje me njohuritë e përfituara gjatë trajnimit.

3. Objektivat kryesorë të këtij procesi janë:

a) Përcaktimi i përshtatshmërisë së nëpunësit civil me pozicionin e punës që ai mban;

b) Zbulimi i aftësive të tij/saj për zhvillimin profesional;

c) Përcaktimi i nevojave për trajnime shtesë.

KREU II**KATEGORIZIMI/GRUPIMI I NËPUNËSVE
CIVILË**

1. Çdo nëpunës civil është i detyruar t'i nënshtrohet, periodikisht, testimit paraprak dhe, kur është e nevojshme, procedurës së trajnimit, sipas këtij vendimi, çdo 4 vjet, dhe, kur nuk është e mundur, ky vlerësim mund të shtyhet deri në 6 vjet.

2. Departamenti i Administratës Publike, në bashkëpunim me njësitë e burimeve njerëzore të institucioneve të administratës shtetërore dhe me njësitë përgjegjëse të institucioneve të pavarura, brenda muajit prill, të çdo viti, harton listat e

nëpunësve që do t'i nënshtrohen, çdo vit, kësaj procedure.

3. Nuk i nënshtrohen kësaj procedure:

a) nëpunësit civilë në periudhë prove;

b) nëpunësit civilë, të cilët janë të pezulluar;

c) nëpunësit civilë, të cilët janë me leje lindjeje.

4. Nëpunësit civilë, sipas shkronjave “b” e “c”, të pikës 3, të kreut II, të këtij vendimi, i nënshtrohen kësaj procedure 1 vit pas sistemimit të tyre në një pozicion pune apo përfundimit të lejes së lindjes.

5. Njësitë përgjegjëse të institucioneve të pavarura, për nëpunësit civilë që do t'i nënshtrohen kësaj procedure, duhet të vënë në dispozicion të DAP-it edhe dosjet personale të nëpunësve, me përshkrimet e pozicioneve të tyre të punës.

6. Brenda muajit maj, të çdo viti, DAP-i, pasi ka përfunduar hartimin e listave, sipas pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, bazuar në dosjet e nëpunësve dhe në përshkrimet e pozicioneve të tyre të punës, bën ndarjen e tyre në kategori dhe grupe të përbashkëta. Në këto kategori/grupe marrin pjesë nëpunësit që kanë përshkrime të pozicioneve të punës të njëjta/përafërta.

KREU III**TESTIMI PARAPRAK**

1. Nëpunësit civilë, të grupuar sipas kreut II, të këtij vendimi, i nënshtrohen procedurës së testimit paraprak.

2. Testimi paraprak duhet të përfshijë të gjitha ndryshimet dhe të rejat që i përkasin fushës përkatëse, sipas kategorisë/grupimit që i përket nëpunësi civil. Ndryshimet dhe të rejat, që do të jenë pjesë e testimit për secilën kategori/grupin, përcaktohen nga DAP-i, në bashkëpunim me institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura, në përputhje me profilin përkatës.

3. DAP-i, në bashkëpunim me ASPA-n përcakton datën e testimit paraprak për çdo kategori/grupim dhe njofton njësitë e burimeve njerëzore të institucioneve, të paktën, një muaj përpara datës së zhvillimit të testimit.

4. Nëpunësit, që do t'i nënshtrohen testimit paraprak, njoftohen nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit ku ata janë të punësuar, të paktën, një muaj përpara datës së përcaktuar për zhvillimin e testimit.



5. Nëpunësit civil i vihet në dispozicion, nëpërmjet publikimit në faqen e internetit të ASPA-s, fusha e njohurive, mbi bazën e së cilës do të zhvillohet testimi, dhe materialet ose referencat përkatëse, të paktën, 20 (njëzet) ditë përpara zhvillimit të testimit.

6. Testimi paraprak i nëpunësve civilë realizohet nga një komision vlerësimi paraprak (KVP), i cili përbëhet nga pesë anëtarë, si më poshtë vijon:

a) një përfaqësues nga DAP-i, për institucionet e administratës shtetërore, ose njësia përgjegjëse, për institucionet e pavarura, i cili kryeson komisionin;

b) një përfaqësues nga ASPA;

c) një anëtar nga TND-ja, i cili zgjidhet nga DAP-i;

ç) dy ekspertë të fushës.

7. Ekspertët zgjidhen nga DAP-i/njësia përgjegjëse për institucionet e pavarura, për secilin KVP, duke pasur në konsideratë karakteristikat e secilit grup nëpunësish për të cilët do të zhvillohet procedura e vlerësimit.

8. Ekspertët zgjidhen nga pedagogët e universiteteve apo institucioneve të tjera të arsimit të lartë, ekspertët e licencuar të fushave të ndryshme, ekspertët që vijnë nga profesionet e rregulluara apo profesionistë të shquar. Ekspertët duhet të kenë, të paktën, 5 (pesë) vjet eksperiencë në atë pozicion pune/profesion.

9. Në rast mospranimi apo largimi të parakohshëm të një eksperti, ai zëvendësohet nga DAP-i/njësia përgjegjëse për institucionet e pavarura, me një ekspert tjetër të së njëjtës fushë.

10. Ekspertët pjesëmarrës në KVP shpërblehen me shumën prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh për çdo procedurë. Të gjitha shpenzimet përballohen, respektivisht, nga buxheti i DAP-it, për institucionet e administratës shtetërore, dhe nga buxheti i institucioneve të pavarura, për personelin e tyre.

11. Në rast se anëtarët e përcaktuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 6, të kreut III, të këtij vendimi, janë në kushtet e pamundësisë ligjore për të qenë anëtarë të KVP-së ose, në mënyrë të pajustificuar, nuk marrin pjesë në KVP, ata zëvendësohen me nëpunës të tjerë të të njëjtut institucion, nga organet e emërtesës.

12. Sistemi i vlerësimit bazohet në:

a) testimin me shkrim, i cili ka 70 pikë;

b) intervistën me gojë, e cila ka 30 pikë.

13. KVP-ja, bazuar në fushën e njohurive për

të cilat do të zhvillohet testimi, përgatit pyetjet për testimin me shkrim dhe për intervistën me gojë.

14. Për vlerësimin e rezultateve për secilin nëpunës, secili prej anëtarëve jep pikët e tij. Në përfundim, pikët mbledhen dhe më pas nxirret mesatarja e përgjithshme, e cila përbën edhe vlerësimin përfundimtar të kandidatit.

15. KVP-ja, brenda 2 ditëve nga përfundimi i procedurës së vlerësimit, duhet të shpallë rezultatet, sipas kësaj skeme:

a) 90 - 100 pikë, “shumë mirë”;

b) 70 - 89 pikë, “mirë”;

c) 51 - 69 pikë, “kënaqshëm”

ç) 0 - 50 pikë, “jo kënaqshëm”.

16. Nëpunësit që janë vlerësuar “shumë mirë” konsiderohen të përshtatshëm për pozicionin e punës që kanë dhe rekomandohen për ngritje në detyrë, në rast se aplikojnë në një procedurë të tillë konkurrimi. Ata nuk kanë nevojë t’i nënshtrohen procedurës së trajnimit.

17. Nëpunësit që janë vlerësuar “mirë” konsiderohen të përshtatshëm për pozicionin e punës ku janë caktuar. Ata nuk kanë nevojë t’i nënshtrohen procedurës së trajnimit.

18. Nëpunësit që janë vlerësuar “kënaqshëm” konsiderohen të përshtatshëm për pozicionin e punës ku janë caktuar, me kushtin që të ndjekin programe trajnimi të vazhdueshme, të cilat synojnë plotësimin e dobësive që kanë shfaqur gjatë kësaj procedure.

19. Përcaktimi i fushave ku duhet të trajnohen nëpunësit e përcaktuar sipas pikës 18, të kreut III, të këtij vendimi, bëhet nga eprori direkt, në bashkëpunim me njësinë përgjegjëse. Ndjekja e programeve vazhduese duhet të realizohet brenda një viti, nga përfundimi i procedurës së testimit paraprak.

20. Programi i trajnimit, për këta nëpunës, hartohet nga ASPA, bazuar në raportin e KVP-së dhe në rekomandimet e DAP-it. Ky program miratohet nga bordi i ASPA-s.

21. Në përfundim të këtyre trajnimeve nëpunësit nuk u nënshtrohen testeve të reja.

22. Nëpunësit që janë vlerësuar “jokënaqshëm” konsiderohen jo të përshtatshëm për pozicionin e punës ku janë caktuar. Ata janë të detyruar të ndjekin trajnimin pranë ASPA-s për përfitim dhe përditësimin e njohurive shtesë, sipas kreut IV, të këtij vendimi.



KREU IV ORGANIZIMI I TRAJNIMEVE

1. Nëpunësit e vlerësuar “jokënaqshëm”, në procedurën e parë të vlerësimit, i nënshtrohen një periudhe vlerësimi 3-mujore, nga eprori direkt, si dhe procedurës së trajnimit për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë, pranë ASPA-s.

2. Procedura e vlerësimit 3-mujor bëhet sipas rregullave dhe formave që parashikon vendimi i Këshillit të Ministrave për vlerësimin e rezultateve në punë. Në përfundim të kësaj procedure, nëpunësi duhet të jetë vlerësuar, të paktën, “kënaqshëm”.

3. Në varësi të kategorive/grupeve, ASPA, në bashkëpunim dhe bazuar në rekomandimet e DAP-it, harton programet e trajnimit për nëpunësit e vlerësuar “jokënaqshëm” në përfundim të procedurës së testimit, të përcaktuar në kreun III, të këtij vendimi.

4. Këto programe duhet të përfshijnë të gjitha ndryshimet dhe të rejat që u përkasin fushave përkatëse, sipas kategorisë/grupimit që do t'i nënshtrohet trajnimit. Programet dhe mënyra e zhvillimit të tyre miratohen nga bordi i ASPA-s dhe duhet të zgjatin nga 10 deri në 20 ditë. ASPA njofton njësitë e burimeve njerëzore të institucioneve për datat e zhvillimit të trajnimit, të paktën, një muaj përpara datës së fillimit të trajnimit.

5. Nëpunësit që do t'i nënshtrohen trajnimit njoftohen nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit ku janë të punësuar, të paktën, një muaj përpara datës së përcaktuar për fillimin e trajnimit.

6. Nëpunësit civil i vihet në dispozicion programi i trajnimit dhe materialet përkatëse, një javë përpara fillimit të trajnimit.

7. Trajnimi organizohet sipas programit e afatit të miratuar dhe prezantohet nga lektorët e përzgjedhur nga ASPA. Pagesa për hartimin e programeve dhe orët e mësimdhënies përcaktohen sipas akteve që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimeve të realizuara prej saj.

8. Pjesëmarrja e nëpunësve civilë në trajnim është e detyrueshme, në masën 75 (shtatëdhjetë e pesë) për qind. Mosrespektimi i kësaj dispozite sjell skualifikimin e nëpunësit nga trajnimi.

9. Në rast skualifikimi, nëpunësi civil është i

detyruar të ndjekë nga fillimi trajnimin përkatës, por brenda periudhës së përcaktuar në pikën 1, të kreut II, të këtij vendimi.

10. Me përfundimin e trajnimit, nëpunësi i nënshtrohet testimit nga komisioni i vlerësimit.

11. Testimi i nëpunësve civilë që kanë përfunduar trajnimin realizohet nga komisioni i vlerësimit (KV), i cili përbëhet nga pesë anëtarë, si më poshtë vijon:

a) një përfaqësues nga DAP-i, për institucionet e administratës shtetërore, ose njësia përgjegjëse për institucionet e pavarura, i cili kryeson komisionin;

b) një përfaqësues nga ASPA;

c) një anëtar nga TND-ja, që zgjidhet nga DAP-i;

ç) dy ekspertë të fushës.

12. Procedurat e përcaktimit të ekspertëve të KV-së, zëvendësimit e pagesës së tyre, si dhe procedurat e zëvendësimit të anëtarëve të tjerë të KV-së, janë të njëjta me ato të përcaktuara në pikat 7, 8, 9, 10 e 11, të kreut III, të këtij vendimi.

13. Sistemi i vlerësimit bazohet në:

a) testimin me shkrim, i cili ka 70 pikë;

b) intervistën me gojë, e cila ka 30 pikë.

14. Komisioni i vlerësimit, bazuar në programin e trajnimit që ka zhvilluar kategoria/grupi, përgatit pyetjet, për testimin me shkrim dhe për intervistën me gojë, të cilave do t'i nënshtrohen nëpunësit civilë.

15. Për vlerësimin e rezultateve për secilin nëpunës, secili prej anëtarëve jep pikët e tij. Në përfundim, pikët mbledhen dhe më pas nxirret mesatarja e përgjithshme, e cila përbën edhe vlerësimin përfundimtar të kandidatit.

16. Komisioni i vlerësimit, brenda 2 ditëve, nga përfundimi i procedurës së vlerësimit, duhet të shpallë rezultatet, sipas kësaj skeme:

a) 90 - 100 pikë, “shumë mirë”;

b) 70 - 89 pikë, “mirë”;

c) 51 - 69 pikë, “kënaqshëm”

ç) 0 - 50 pikë, “jo kënaqshëm”.

17. Nëpunësit që janë vlerësuar “shumë mirë” dhe “mirë” konsiderohen të përshtatshëm për pozicionin e punës që kanë.

18. Nëpunësit që janë vlerësuar “kënaqshëm” konsiderohen të përshtatshëm për pozicionin e punës ku janë caktuar, me kushtin që të ndjekin programe trajnimi të tjera, të cilat synojnë plotësimin e dobësive që kanë shfaqur gjatë kësaj procedure.



19. Përcaktimi i fushave ku duhet të trajnohen nëpunësit e përcaktuar sipas pikës 18, të kreut IV, të këtij vendimi, bëhet nga KV-ja. Programi i trajnimit për këta nëpunës hartohet nga ASPA, bazuar në raportin e KV-së dhe në rekomandimet e DAP-i. Ky program miratohet nga bordi i ASPA-s.

20. Në përfundim të këtyre trajnimeve nëpunësit nuk i nënshtrohen testeve të reja.

21. Nëpunësit që janë vlerësuar “jokënaqshëm” konsiderohen se nuk e kanë kaluar testimin pranë KV-së.

22. Në përfundim të procedurave të mësipërme, bazuar në rezultatet e testimit të realizuar nga KV-ja dhe në rezultatet e vlerësimit 3-mujor, eprori direkt vendos përshtatshmërinë ose jopërshtatshmërinë e nëpunësit civil në pozicionin e punës.

23. Në rast se nëpunësi vlerësohet jo i përshtatshëm, atëherë njësia e burimeve njerëzore deklaron përfundimin e marrëdhënieve në Shërbimin Civil.

KREU V

VLERËSIMI I NËPUNËSVE CIVILË SIPAS TESTEVE TË NJOHURA NDËRKOMBËTARISHT

1. Vlerësimi i nëpunësve civilë për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë mund të bëhet edhe nga shoqëri private, mbi bazën e programeve dhe testeve të njohura ndërkombëtarisht.

2. Për këtë qëllim, ASPA, pasi ka marrë miratimin e DAP-it, lidh marrëveshje me shoqëritë private, të cilat ofrojnë trajnime dhe teste të njohura ndërkombëtarisht dhe që mbulojnë fushën e veprimtarisë së nëpunësit.

3. Hapja e procedurës dhe vlerësimi i ofertave për këtë procedurë bëhet sipas legjislacionit për prokurimin publik.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ky vendim i shtrin efektet nga data 1 janar 2016.

2. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike dhe Departamenti i Administratës Publike, brenda vitit 2015, detyrohen të krijojnë infrastrukturën e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 1038, datë 16.12.2015

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. AGIM GJONÇAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 932, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2015”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Agim Gjonçaj, në shumën 900 000 (nëntëqind mijë) lekë.

2. Kjo shumë të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Paga të bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse, origjinale, të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 1039, datë 16.12.2015

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR EMETIMIN, PRODHIMIN, PËRDORIMIN DHE TREGTIMIN E PULLËS POSTARE SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 43, të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e procedurave për emetimin, prodhimin, përdorimin dhe tregtimin e pullës postare shqiptare sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.



2. Vendimi nr. 405, datë 27.7.2000, i Këshillit të Ministrave, “Për kushtet e nxjerrjes së pullës postare shqiptare”, i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Posta Shqiptare sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLA

PËR EMETIMIN, PRODHIMIN, PËRDORIMIN DHE TREGTIMIN E PULLËS POSTARE SHQIPTARE

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky dokument përcakton rregullat për emetimin, prodhimin, përdorimin, tematikën dhe tregtimin e pullës postare shqiptare nga shoqëria Posta Shqiptare sh.a., në përputhje me rregullat ndërkombëtare të Bashkimit Postar të Përbotshëm (UPU).

Neni 2

Pulla postare shërben për pagesën e shërbimeve postare që kryhen në zyrat e operatorit publik postar Posta Shqiptare sh.a., për pranimin, përpunimin, dhe shpërndarjen e objekteve postare brenda dhe jashtë Shqipërisë. Pulla postare shërben dhe për qëllime filatelike.

Neni 3

Pulla postare shqiptare duhet të ofrohet për çdo shtetas shqiptar apo të huaj pa diskriminim. Për pagesën e shërbimit postar pranohen vetëm pullat postare të papërdorura dhe pa dëmtime fizike.

Neni 4

Operatori publik postar, Posta Shqiptare sh.a., ka të drejtën ekskluzive për prodhimin, emetimin, vënien në qarkullim dhe tërheqjen nga qarkullimi të pullave postare shqiptare sipas përcaktimeve në këtë rregullore.

KREU II

KËRKESA PËR PËRMBAJTJEN E PULLËS POSTARE

Neni 5

Pullat postare shqiptare u kushtohen ngjarjeve më të rëndësishme dhe figurave të shquara historike, shoqërore, ekonomike, shkencore, kulturore, artistike, sportive, trashëgimisë kulturore të vendit, florës dhe faunës nga vendi dhe bota.

Neni 6

1. Tematika dhe motivet e pullave postare duhet të jenë shprehje e identitetit kulturor të vendit, të kontribuojnë në promovimin e kulturës ose të ruajtjes së paqes në botë.

2. Pullat postare duhet të jenë në përputhje me aktet e Bashkimit të Përbotshëm Postar për nxitje të bashkëpunimit ndërmjet vendeve anëtare të UPU-së, si dhe me rregulloren e UPU-së për pullat postare.

3. Në rastin e pullave përkujtimore për personalitete të shquara, të ngjarjeve të rëndësishme për vendin ose në rastin e personaliteteve apo të ngjarjeve ndërkombëtare, ato duhet të dëshmojnë një lidhje të ngushtë me Shqipërinë. Tematikat dhe motivet e pullave postare duhet të jenë të zhveshura nga ndikimi politik, si dhe të mos përmbajnë elemente me natyrë fyese.

Neni 7

Pulla postare shqiptare duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

- a) Titullin dhe vitin e emetimit;
- b) Emërtesën “SHQIPËRIA”;
- c) Vlerën nominale, të shprehur në lekë.

KREU III

MBROJTJA E PRONËSISË INDUSTRIALE

Neni 8

1. Simbolet zyrtare të një shteti apo institucioni, si dhe logot e organizatave ndërqeveritare që figurojnë në pullat postare shqiptare janë të mbrojtura, në kuptimin e Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale.

2. Gjatë prodhimit dhe emetimit të një emisioni pulle postare, Posta Shqiptare sh.a., është e detyruar



të veprojë në përputhje me të gjitha detyrimet e legjislacionit shqiptar në fuqi për të drejtën e autorit dhe atë të pronësisë industriale lidhur me përdorimin e logove, simboleve zyrtare etj.

KREU IV PROGRAMI TEMATIK VJETOR I PULLËS POSTARE SHQIPTARE

Neni 9

Në programin tematik vjetor të pullës postare përfshihen:

- a) tematika e emisioneve të pullave postare dhe numri i pamjeve për çdo emision, që përcaktohen nga Komisioni Shtetëror i Pullës Postare Shqiptare;
- b) tirazhi i prodhimit, të dhënat teknike për pullat, blloqet, F, D, C, Kart Max, kartat postare, që miratohen nga Posta Shqiptare sh.a.;
- c) datat e emetimit të emisioneve të pullave që miratohen nga Komisioni, me propozim të Posta Shqiptare sh.a.

Neni 10

Tematikat e emisioneve vjetore të pullës postare shqiptare miratohen nga Komisioni Shtetëror i Pullës Postare Shqiptare (më poshtë referuar “Komisioni”) që funksionon pranë ministrit përgjegjës për shërbimet postare, sipas këtyre rregullave.

Neni 11

1. Posta Shqiptare sh.a., përcakton tirazhin e prodhimit për emisionet e pullave postare në mënyrë që të përmbushë nevojat për ofrimin e shërbimeve postare, si dhe kërkesat për qëllime filatelike.

2. Posta Shqiptare sh.a., në përcaktimin e të dhënave teknike për pullat, blloqet, F, D, C, Kart Max, kartat postare mban parasysh rregullat e përcaktuara nga UPU-ja. Para emetimit të pullave postare, për të cilat përdoren materiale ose teknologji të reja, Posta Shqiptare sh.a., duhet të informojë Byronë e UPU-së në lidhje me përputhshmërinë e tyre me makineritë e përpunimit postar.

KREU V KOMISIONI SHTETËROR I PULLËS POSTARE SHQIPTARE

Neni 12

1. Komisioni Shtetëror i Pullës Postare Shqiptare ka në përbërje 13 anëtarë, të cilët emërohen nga ministri, si më poshtë vijon:

- a) Një përfaqësues nga Ministria e Kulturës;
- b) Një përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- c) Dy përfaqësues të ministrisë/ministrit përgjegjës për shërbimet postare;
- ç) Tre përfaqësues të shoqërisë Posta Shqiptare sh.a.;
- d) Një përfaqësues nga Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë;
- dh) Një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave;
- e) Një përfaqësues nga Instituti i Historisë;
- ë) Një përfaqësues nga Akademia e Shkencave;
- f) Një përfaqësues të shoqatës së filatelistëve;
- g) Një përfaqësues nga Galeria Kombëtare e Arteve, me profesion piktor.

2. Kryetari i Komisionit është drejtori i drejtorisë përgjegjëse për shërbimin postar pranë ministrit.

Neni 13

Komisioni vepron në përputhje me ligjin për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale. Komisioni mund të marrë një vendim të vlefshëm vetëm nëse janë të pranishëm jo më pak se gjysma e anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm, dhe, në rast barazimi votash, vota e kryetarit është përcaktuese. Rregulla të detajuara për funksionimin e Komisionit miratohen me udhëzim të ministrit.

Neni 14

Anëtarët e Komisionit, për veprimtarinë që kryejnë, marrin një pagesë prej 5 000 (pesë mijë) lekësh për mbledhje. Numri maksimal i mbledhjeve të paguara në vit është 10. Pagesa e anëtarëve të Komisionit përballohet nga Posta Shqiptare sh.a.



KREU VI
PROPOZIMET PËR TEMATIKAT E
PULLAVE

Neni 15

1. Komisioni miraton tematikën vjetore të pullës brenda tremujorit të parë të çdo viti për vitin e dytë pasardhës, në bazë të propozimeve të sjella nga ministritë, institucionet e tjera shkencore, artistike, shoqatat e ndryshme dhe Posta Shqiptare sh.a. Vetëm për vitin e parë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, miratimi i tematikave të pullës bëhet për dy vitet e para në vijim.

2. Në programin vjetor si rregull përfshihen 10-12 emisione. Komisioni, në bazë të kërkesave të arsyetuara të Postës Shqiptare sh.a., ose të institucioneve mund të miratojë shtesë në tematikat vjetore të pullës për ngjarje të rëndësishme që lindin pas momentit të vendimmarrjes (por jo më shumë se 2 (dy) emisione shtesë).

Neni 16

Ministritë, shoqëria Posta Shqiptare sh.a., institucionet e tjera shkencore, artistike, si dhe shoqata të ndryshme dërgojnë propozimet për tematikën vjetore të pullës postare, sipas fushës së veprimtarisë që mbulojnë për ngjarje të rëndësishme dhe figura të shquara politike, shoqërore, ekonomike, historike, shkencore, kulturore, artistike, sportive, veprimtari kushtuar florës dhe faunës nga vendi dhe bota brenda muajit janar të çdo viti, për vitin e dytë pasardhës. Vetëm për vitin e parë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, propozimet për tematika do të jenë për dy vitet e para në vijim.

Neni 17

1. Propozimet për tematika të pullave postare bazohen në kriteret e mëposhtme:

a) Pullat postare përkujtimore të lëshohen për festimin e ditëlindjeve, përvjetorëve dhe kontributeve të rëndësishme të personaliteteve të shquara;

b) Pullat postare përkujtimore të lëshohen për nderimin e personaliteteve të shquara pas vdekjes së tyre;

c) Ngjarjet e rëndësishme historike të konsiderohen për përkujtim si rregull për përvjetorët, çdo 25/50 vjet; deri në 100 vjet dhe për çdo 100 vjet;

ç) Pullat postare mund të pasqyrojnë florën dhe faunën shqiptare;

d) Pullat postare mund të pasqyrojnë monumente të kulturës, aspekte të aktiviteteve politiko-shoqërore, me rëndësi kombëtare ose ndërkombëtare që do të zhvillohen gjatë vitit.

2. Propozimet për pullat postare duhet të jenë shoqëruara me përshkrimin përkatës dhe, sipas rastit, me imazhe, foto në rast se kanë.

KREU VII
BOCETAT PËR EMISIONET E PULLAVE

Neni 18

1. Pas miratimit të tematikës vjetore të emisioneve të pullave postare nga Komisioni, Posta Shqiptare sh.a., organizon konkurrimin për punime artistike, skica dhe boceta për çdo emision pule, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Konkurrimi është i hapur për pjesëmarrje pa diskriminim të artistëve/piktorëve. Posta Shqiptare sh.a., merr masa për publikimin në kohë të njoftimit për hapjen e konkursit, ku do të paraqiten punime artistike për realizimin e emisioneve të pullave postare, publikimi i cili duhet të bëhet në një gazetë me tirazh të lartë, si dhe në faqen zyrtare të Posta Shqiptare sh.a.

Neni 19

1. Punimet e paraqitura në procedurën e konkurrimit duhet të jenë në bocetë origjinale dhe të formatuara në material elektronik. Boceti duhet të paraqitet në format A4, si dhe në formatin e printuar të pullës postare.

2. Çdo punim artistik, skice, bocete, i paraqitur nga konkurrentët, duhet të shoqërohet me deklaratën që punimi është origjinal dhe nuk shkel të drejtat e autorit.

Neni 20

Në fund të afatit përfundimtar të konkurrimit, Posta Shqiptare sh.a., kërkon mbledhjen e Komisionit për vlerësimin e punimeve të paraqitura. Punimet e paraqitura nga konkurrenca dhe të dorëzuara në zarfe të mbyllura në protokollin e Posta Shqiptare sh.a., hapen vetëm në prezencë të anëtarëve të Komisionit.



Neni 21

Komisioni, me shumicë votash, shpall konkurrentët fitues me tri çmime, çmimi i parë, i dytë dhe i tretë. Vendimi i Komisionit i njoftohet zyrtarisht Posta Shqiptare sh.a., e cila, sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin nr. 595, datë 29.12.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e shpalljes së konkurruesve me karakter kombëtar e lokal dhe dhënien e çmimeve për ta”, njofton fituesit e çmimeve. Bocetat e konkurrentëve fitues ruhen në magazinën e Muzeut të Pullës, pranë Posta Shqiptare sh.a.

Neni 22

Shpërblimi i konkurruesve që fitojnë çmimet nga i pari tek i treti bëhet nga Posta Shqiptare sh.a. Masa e shpërblimit përcaktohet me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Posta Shqiptare sh.a, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU VIII

PROCEDURAT E PRODHIMIT TË PULLAVE POSTARE

Neni 23

Shoqëria Posta Shqiptare sh.a., për prodhimin e të gjitha pullave postare zbaton procedurat sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 24

Pullat postare shqiptare shtypen në ente të specializuara, të zgjedhura në mbështetje të dispozitave në fushën e prokurimeve. Në çdo rast, konkurrentët duhet të jenë të pajisur me dokumentacionin e nevojshëm për shtypjen e letrave me vlerë, certifikatë cilësie dhe sigurie të shtypit.

Neni 25

Shtypja, marrja në dorëzim, administrimi, shpërndarja dhe shitja e pullave postare shqiptare bëhen nga Posta Shqiptare sh.a., në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, të cilat rregullojnë shërbimet e letrave me vlerë.

KREU IX

VËNIA NË QARKULLIM E EMISIONEVE TË PULLAVE POSTARE VJETORE

Neni 26

Vënia në qarkullim e emisioneve të reja të pullës postare shqiptare miratohet nga kryetari i Komisionit Shtetëror të Pullës Postare Shqiptare, i cili në dy tabakë shënon: “Lejohet të qarkullojë” dhe poshtë vendos firmën dhe datën. Një tabak i çdo emisioni të pullave postare i miratuar sipas këtyre rregullave ruhet në Muzeun e Pullës Postare Shqiptare dhe një tabak ruhet në ministri.

Neni 27

Kur një emision hiqet nga qarkullimi për qëllime filatelike, ai emision qëndron në qarkullim për të plotësuar nevojat e shërbimit postar deri sa vlefte e tyre u përgjigjet tarifave të shërbimit postar.

KREU X

TREGTIMI I PULLAVE POSTARE

Neni 28

Çmimi i një emisioni të pullave postare miratohet nga Posta Shqiptare sh.a., në përputhje me tarifat e shërbimit postar, si dhe me kërkesat e tregut filatelik. Përcaktimi i çmimit të shitjes në valutë për emisionet e pullave postare bëhet me vendim të shoqërisë Posta Shqiptare sh.a., në bazë të çmimeve të përcaktuara në lekë. Çmimet për emisionet e pullave publikohen në faqen zyrtare të Posta Shqiptare sh.a., si dhe në çdo zyrë postare.

Neni 29

Posta Shqiptare sh.a., organizon shitjen e pullave postare për nevoja të shërbimit në zyrat postare. Shitja e pullave postare shqiptare për qëllime filatelike brenda dhe jashtë vendit bëhet edhe me ndërmjetësinë e shoqërive e të agjencive tregtare, vendase ose të huaja.

Neni 30

1. Për shitje me sasi të mëdha të pullave për qëllime filatelike, Posta Shqiptare sh.a., mund të aplikojë zbritje kundrejt çmimit nominal, si më poshtë vijon:

a) Për seri të plota, të pavulosura, deri në masën 20%;



b) Për seri të shkurtuara, të vulosura, deri në masën 80%;

c) Për emisionet e mbetura stok, të emetuara deri në vitin 1993, vlera nominale e të cilave është shprehur në qindarka dhe lekë, deri në masën 30% kundrejt vlerës së konvertuar në dollarë amerikanë, sipas kursit të këmbimit të periudhës përkatëse të emetimit të serisë, me të cilën është përcaktuar çmimi i shitjes në dollarë amerikanë.

2. Sasitë e shitjes së pullës postare shqiptare, për të cilat aplikohet zbritje sipas pikës 1, përcaktohen me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Posta Shqiptare sh.a.

Neni 31

Të ardhurat, që sigurohen nga shitja e emisioneve të pullave të reja e të vjetra, si dhe e materialeve të tjera të lidhura me to, arkëtohen në favor të shoqërisë Posta Shqiptare sh.a.

KREU XI

RUAJTJA DHE ADMINISTRIMI I PULLAVE POSTARE SHQIPTARE

Neni 32

Ruajtja e administrimi i pullave postare dhe i materialeve të tjera filatelike të vendit bëhet sipas dispozitave ligjore në fuqi për ruajtjen dhe administrimin e letrave me vlerë.

Neni 33

Vendet e caktuara për ruajtjen e emisioneve të pullave postare duhet të plotësojnë kushtet e veçanta të ruajtjes së pullës postare. Ato duhet të ruhen nga lagështira e tepërt dhe temperaturat e larta, në mënyrë që pullat postare të mos dëmtohen e të mos humbasin anën artistike e fiziko-kimike të tyre.

Neni 34

Shoqëria Posta Shqiptare sh.a., merr të gjitha masat tekniko-organizative për ruajtjen dhe administrimin e pullës postare shqiptare pranë magazinës së Muzeut të Pullës Postare Shqiptare.

Sasia e pullave postare në ruajtje përcaktohet me udhëzim të ministrit, ndërsa ato që i dërgohen Bashkimit Postar të Përbotshëm (UPU-së) përcaktohen sipas rregullave të UPU-së.

Neni 35

Shoqëria Posta Shqiptare sh.a., për të plotësuar kërkesa dhe nevoja të tjera të saj mban një gjendje të pullave postare në magazinë, sasia e të cilës përcaktohet nga vetë ajo.

Neni 36

Për emisionet e pullave postare të mbetura stok, që kanë humbur mundësinë e përdorimit për qëllime tarifimi të shërbimit postar apo për qëllime filatelike, si dhe ato që për shkak të qëndrimit të gjatë kanë humbur parametrat cilësorë e fiziko-kimikë të tyre, shoqëria Posta Shqiptare sh.a., ka të drejtën e asgjësimit të tyre, duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 37

Me qëllim promovimin e pullës postare shqiptare, të vlerave të saj filatelike, Posta Shqiptare sh.a., bën publikimin e pullave postare shqiptare, nëpërmjet materialeve informative promovuese, simpoziumeve dhe pjesëmarrjes në ekspozita e panairë kombëtare e ndërkombëtare.

KREU XII

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 38

Të gjitha shpenzimet që bëhen për përgatitjen e tematikës vjetore, boceteve, prodhimit, publikimeve, organizimit të konkurseve, tenderave, pjesëmarrjes në panairë dhe ekspozita, si dhe shpenzime të tjera publiciteti përballohen nga Posta Shqiptare sh.a.

Neni 39

Vetëm për vitin e parë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, prodhimi i pullës postare do të përfshijë emisionet e vitit në vijim dhe ato për vitin pasardhës. Pas vitit të parë, prodhimi i pullës postare do të bëhet çdo vit për vitin pasardhës.

**VENDIM****Nr. 1040, datë 16.12.2015**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI I
RRUGËVE TË BLOKUT 59 QË
KUFIZOHET NGA BULEVARDI “BAJRAM
CURRI”, RRUGA “ALI DEMI” DHE
RRUGA E “PLANIT RREGULLUES”, NË
BASHKINË E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugëve të bllokut 59 që kufizohet nga bulevardi “Bajram Curri, rruga “Ali Demi” dhe rruga e “Planit rregullues”, në Bashkinë e Tiranës, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen, sipas vlerës

përkatese për sipërfaqen prej 1 080.2 (një mijë e tetëdhjetë pikë dy) m² truall, në vlerën e përgjithshme të shpronësimit 44 059 821.2 (dyzet e katër milionë e pesëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzet e një pikë dy) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 44 059 821.2 (dyzet e katër milionë e pesëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzet e një pikë dy) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Tiranës.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë e Tiranës, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë 1 080.2 (një mijë e tetëdhjetë pikë dy) m² truall, për rikonstruksionin e rrugëve të bllokut 59, që kufizohet nga bulevardi “Bajram Curri, rruga “Ali Demi” dhe rruga e “Planit rregullues”, bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama**

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E TË CILËVE DO TË SHPRONËSOHEN PËR
REALIZIMIN E PROJEKTTIT RIKONSTRUKSIONI I RRUGËVE TË BLOKUT 59 QË
KUFIZOHET NGA BULEVARDI “BAJRAM CURRI”, RRUGA “ALI DEMI” DHE RRUGA E
“PLANIT RREGULLUES”, NË BASHKINË E TIRANËS**

Nr.	Emër, mbiemër	Zona kadastr.	Nr. i pasurisë	Sip. e përgj. e truallit në m ²	Sip. e prekur truallit në m ²	Çmimi për truallin	Vlera e përgjith. në lekë	Konf. ZVRPP, Tiranë
1	Arben Disha	8180	3/216	181	30	30.059	901770	Shkr. nr. 25166/1, datë 30.4.2015
2	Kujtim Duçkollari	8180	3/205	101	46	30.059	1382714	Shkr. nr. 25166/1, datë 30.4.2015
3	Sokol Krasniqi	8180	2/131	483	29	30.059	871711	Shkr. nr. 25166/1, datë 30.4.2015
4	Shpëtim Ibro	8180	3/261	210	99	30.059	2975841	Shkr. nr. 25166/1, datë 30.4.2015
5	Rezart Stefa	8180	3/217	168	90	30.059	2705310	Shkr. nr. 25166/1, datë 30.4.2015
6	Durim Zeqiri	8180	2/128	112	112	30.059	3366608	Shkr. nr. 25166/1, datë 30.4.2015
7	Ylvi Kazazi	8150	8/502	188	188	57.126	10739688	Shkr. nr. 17716/2, datë 20.7.2015
8	Bashkpr. Çeliku	8150	8/793	144	144	57.126	8226144	Shkr. nr. 17716/3, datë 20.7.2015
9	Bashkpr. Tetova	8180	2/116	246	246	30.059	7394514	Shkr. nr. 25166/1, datë 30.4.2015
10	Bashkpr. Leskaj, Papa	8150	8/724	72.5	72.5	57.126	4141635	Shkr. nr. 17716/2, datë 20.7.2015
11	Bashkpr. Qoqja,	8150	8/544	23.7	23.7	57.126	1353886	Shkr. nr. 17716/2, datë 20.7.2015
TOTALI					1 080.2	SHUMA	44 059 821.2	

**VENDIM****Nr. 1041, datë 16.12.2015**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I INFRASTRUKTURËS SË BLOKUT 61,
QË KUFIZOHET NGA RRUGA “QEMAL
STAFI” DHE RRUGA E “PLANIT
RREGULLUES”, SI DHE “NDËRTIMI
DHE MOBILIMI URBAN I
SIPËRFAQEVE TË ZONËS 61/1”,
NË BASHKINË E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i infrastrukturës së bllokut 61, që kufizohet nga rruga “Qemal Stafa” dhe rruga e “Planit rregullues”, si dhe “Ndërtimi dhe mobilimi urban i sipërfaqeve të zonës 61/1”, në Bashkinë e Tiranës, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen sipas vlerave përkatëse të listës bashkëlidhur këtij vendimi, për

sipërfaqen “truall”, prej 10 447.46 (dhjetë mijë e katërqind e dyzet e shtatë pikë dyzet e gjashtë) m², në vlerën 222 520 451 (dyqind e njëzet e dy milionë e pesëqind e njëzet mijë e katërqind e pesëdhjetë e një) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 222 520 451 (dyqind e njëzet e dy milionë e pesëqind e njëzet mijë e katërqind e pesëdhjetë e një) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Tiranës.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë e Tiranës, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë truall, prej 10 447.46 (dhjetë mijë e katërqind e dyzet e shtatë pikë dyzet e gjashtë) m², për projektin “Leje ndërtimi për infrastrukturën e bllokut 61, që kufizohet nga rruga “Qemal Stafa” dhe rruga e “Planit rregullues”, si dhe “Ndërtimi dhe mobilimi urban i sipërfaqeve të zonës 61/1”, në Bashkinë e Tiranës, të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama**

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E TË CILËVE DO TË SHPRONËSOHEN PËR
REALIZIMIN E PROJEKTTIT PËR “LEJE NDËRTIMI PËR INFRASTRUKTURËN E BLOKUT 61 QË
KUFIZOHET NGA RRUGA “QEMAL STAFI” DHE RRUGA E “PLANIT RREGULLUES”, SI DHE
“NDËRTIMI DHE MOBILIMI URBAN I SIPËRFAQEVE TË ZONËS 61/1”, NË BASHKINË E
TIRANËS**

Nr.	Emër, mbiemër	Z. kad.	Nr. i pas.	Sip. e përgj.	Sip. e prekur	Çmimi Tr.	Vlera në lekë	Konfirmim nga ZVRPP-ja, Tiranë
1	Armir Arif Boja, Lulzim Arif Boja	8130	3/162	250	250	21,299	5,324,750	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
2	Syrja Muhamet Shenaj	8130	3/265	150	150	21,299	3,194,850	Konfirm. shkr. nr. 18272/1, prot. datë 27.03.2015
3	Bashkpr. Kullakshi, Shima, Boriçi	8130	3/259	271	271	21,299	5,772,029	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot. datë 27.3.2015
4	Xane Halit Kaçi	8130	5/219	108	10	21,299	212,990	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
5	Bashk. Turku, Derhemi, Agalliu	8130	3/666	2913	2913	21,299	62,043,987	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
6	Bashkpr. Frasholli	8130	5/215	300	300	21,299	6,389,700	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015



7	Bashkpr. Frasholli	8130	5/216	250	250	21,299	5,324,750	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
8	Haxhi Hidri	8130	3/362	47.2	47.2	21,299	1,005,313	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
9	Haxhi Hidri	8130	3/247	112	112	21,299	2,385,488	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
10	Mentor Gani Hysa	8130	4/127	570	80	21,299	1,703,920	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
11	Petrit Adem Hysa	8130	4/61	670	161	21,299	3,429,139	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
12	Bektash Xhemal Prapa, Fatbardha Rakip Prapa	8130	3/310	110	110	21,299	2,342,890	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
13	Bektash Xhemal Prapa, Fatbardha Rakip Prapa	8130	3/309	265	265	21,299	5,644,235	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
14	Sokol Fasli Bastri	8130	5/234	300	145	21,299	3,088,355	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
15	Vjollca Muharrem Bundo	8130	5/212	110	110	21,299	2,342,890	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
16	Ahmet Rexhep Prushi	8130	5/211	970	970	21,299	20,660,030	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
17	Eduard, Eqerem, Dritan Qazimi	8130	3/261	516	516	21,299	10,990,284	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
18	Dritan Xheladin Qazimi	8130	3/353	270	23	21,299	489,877	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
19	Lutfe Dervishi	8130	3/268	78	78	21,299	1,661,322	Konfirm. shkr. nr. 123/1 prot., datë 17.1.2013
20	Bute Rexhep Demiraj	8130	5/711	112.91	21	21,299	447,279	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
1	Ismail Hysen Xhurra	8130	5/260	1655	444	21,299	9,456,756	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
2	Ismail Hysen Xhurra	8130	3/393	60	60	21,299	1,277,940	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
3	Ismail Hysen Xhurra	8130	5/724	184	134	21,299	2,854,066	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
4	Ismail Hysen Xhurra	8130	5/251	1254	280	21,299	5,963,720	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
5	Ismail Hysen Xhurra	8130	3/377	2041	1,260	21,299	26,836,740	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
6	Ismail Hysen Xhurra	8130	5/250	281	88	21,299	1,874,312	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
7	Ismail Hysen Xhurra	8130	5/226	580	580	21,299	12,353,420	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
8	Ismail Hysen Xhurra	8130	3/379	113	24	21,299	511,176	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
9	Ismail Hysen Xhurra	8130	3/392	190	190	21,299	4,046,810	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
10	Ismail Hysen Xhurra	8130	3/345	1753	332	21,299	7,071,268	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
11	Ismail Hysen Xhurra	8130	5/712	21,26	21,26	21,299	452,817	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
12	Ismail Hysen Xhurra	8130	5/271	126	126	21,299	2,683,674	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
13	Ismail Hysen Xhurra	8130	5/47	252	23	21,299	489,877	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
14	Ismail Hysen Xhurra	8130	3/323	240	19	21,299	404,681	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
15	Ismail Hysen Xhurra	8130	3/324	240	18	21,299	383,382	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
16	Ismail Hysen Xhurra	8130	3/325	240	66	21,299	1,405,734	Konfirm. shkr. nr. 18272/1 prot., datë 27.3.2015
	Totali				10 447.46 m²		222 520 451	

VENDIM**Nr. 1042, datë 16.12.2015**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT
“NDËRTIMI I LINJËS SË RE TË
UJËSJELLËSIT TË DURRËSIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në

përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Ndërtimi i linjës së re të ujësjellësit të Durrësit”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Ujësjellës-Kanalizimeve, Durrës sh.a.



3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “arë”, “kultura bujqësore” dhe “drurë frutorë”, në vlerën e përgjithshme të shpronësimit prej 4 405 228 (katër milionë e katërqind e pesë mijë e dyqind e njëzet e tetë) lekësh, nga të cilat:

a) tokë “arë”, me vlerë 3 123 000 (tre milionë e njëqind e njëzet e tre mijë) lekë;

b) “kultura bujqësore”, me vlerë 44 879 (dyzet e katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë;

c) “drurë frutorë”, me vlerë 1 237 349 (një milion e dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e treqind e dyzet e nëntë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 4 405 228 (katër milionë e katërqind e pesë mijë e dyqind e njëzet e tetë) lekësh, përballohet nga zëri “Kosto lokale”, me kod “M063149”, parashikuar në buxhetin e vitit 2015 për Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga njësia e zbatimit të projektit të Bankës Botërore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve kryen likuidimet, për efekt shpronë-

simi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kurbin, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve dhe Ujësjetllës-Kanalizime, Durrës sh.a., të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve, dhe me fillimin e procesit të likuidimit të fillojë dhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kurbin të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve, Ujësjetllës-Kanalizime, Durrës sh.a., Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



TABELË
LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT TË RI TË DURRËSIT
(ARË + KULTURA BUJQËSORE + DRUFRUTORE)

Nr.	Komuna/Fshati	Emërtimi i pusit	Emër, mbiemër i pronarit	Nr. i parcelës	Nr. i kadastrës	Nr. i pronarëve	Statusi ligjor i pronësisë	Tipi i tokës	Sipërfaqe totale (m ²)	Vlerësimi i Sipërfaqes për Shpronësim (m ²)				Vlerësimi i Bimësisë për Kompensim (ALL)			Shuma totale e kompensimit
										Sipërfaqe që shpronësohet (m ²)	Çmimi (ALL/ m ²)	Vlera e shpronësimit (ALL)	Statusi ligjor në ZVRPP	Bimë të arave (ALL)	Drufrutorë (ALL)	Vlera e kompensimit (ALL)	
1	Komuna Milot/fshati Fushe Milot	FM A	Ndue Lazer Mehilli	40/14	2580	1	regjistruar	tokë bujqësore	6,700	625	1,000	625,000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	-	-	-	625,000
2	Komuna Milot/fshati Fushë-Milot	FM 1	Loro Gjon Kolaj	38/17	1677	1	regjistruar	tokë bujqësore	4,000	493	1,000	493,000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	-	610,397	610,397	1,103,397
3	Komuna Milot/fshati Fushë-Milot	FM B	Ismet Taf Veseli	43/2	1677	1	regjistruar	tokë bujqësore	18,000	465	1,000	465,000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	-	7,212	7,212	472,212
4	Komuna Milot/fshati Fushë-Milot	FM B	Xhumaile Adbulla Veseli	43/44	1677	1	regjistruar	tokë bujqësore	2,016	435	1,000	435,000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	44,879	-	44,879	479,879
5	Komuna Milot/fshati Fushë-Milot	FM D	Murat Hasan Veseli	42/26	1677	1	regjistruar	tokë bujqësore	1,850	480	1,000	480,000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	-	619,740	619,740	1,099,740
6	Komuna Milot/fshati Fushë-Milot	FM E	Alush Haxhiu	70/43	2580	1	regjistruar	tokë bujqësore	4752	625	1,000	625,000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja	-	-	-	625,000
TOTALI												3 123 000		44,879	1 237 349	1 282 228	4405228

**VENDIM****Nr. 1043, datë 16.12.2015****PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 408, DATË 13.5.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË
ZHVILLIMIT TË TERRITORIT”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores së zhvillimit të territorit, miratuar me vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 9, të nenit 25, pas fjalëve “... dokumenti i lejes ...” shtohen “... sipas shtojcës C të këtij vendimi ...”.

2. Në tekstin e shtojcës C të rregullores, fjalët “Kryetari i bashkisë/KKT” zëvendësohen me “Kryetari i bashkisë/Sekretari i KKT-së”.

3. Në nenin 45, shkronja “c” zëvendësohet me fjalitë, si më poshtë vijon:

“Për objektet mbi 6 kate, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të këtij neni, leja e ndërtimit jepet nga autoriteti vendor përgjegjës pas kontrollit paraprak pa vërejtje të Këshillit Kombëtar të Territorit, brenda 10 (dhjetë) ditëve, lidhur me përputhshmërinë me instrumentet kombëtare dhe/ose vendore të planifikimit në proces. Me kalimin e afatit 10-ditor, pa vërejtje nga Këshilli Kombëtar i Territorit, kontrolli i përputhshmërisë konsiderohet i përfunduar pozitivisht dhe kërkesa për leje shqyrtohet nga autoriteti vendor përgjegjës.

Ngarkohen ZVRPP-të përkatëse për të pasqyruar/regjistruar në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme ndryshimet e ndodhura në kategoritë e resurseve, që vijnë si pasojë e miratimit të dokumenteve të planifikimit të territorit sipas këtij neni dhe vendimit nr. 5, datë 29.12.2014, të Këshillit Kombëtar të Territorit për miratimin e zonave të urbanizuara të

territorit. Certifikata e pronësisë e përditësuar si më sipër i lëshohet pronarit të pasurisë së paluajtshme, me kërkesë të këtij të fundit”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 1044, datë 16.12.2015****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I
MARRËVESHJES ME SHKËMBIM
NOTASH, NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS
POPULLORE TË KINËS, “MBI
RECIPROCITETIN E GODINAVE KU
AKOMODOHEN PËRFAQËSIA
DIPLOMATIKE E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, NË PEKIN, DHE
PËRFAQËSIA DIPLOMATIKE E
REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS,
NË TIRANË”, NËNSHKRUAR MË
10.4.1960**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 8, shkronja “a”, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës, “Mbi reciprocitetin e godinave ku akomodoohen përfaqësia diplomatike e Republikës së Shqipërisë, në Pekin, dhe përfaqësia diplomatike e Republikës Popullore të Kinës, në Tiranë”, nënshkruar më 10.4.1960.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Punëve të Jashtme.



3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë tokë “truall”, me sipërfaqe 8 223.8 (tetë mijë e dyqind e njëzet e tre pikë tetë) m², dhe vlerë 197 001 129.5 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë e një mijë e njëqind e njëzet e nëntë pikë pesë) lekë.

4. Vlera e shpronësimit, prej 197 001 129.5 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë e një mijë e njëqind e njëzet e nëntë pikë pesë) lekësh, të përballohet nga llogaria e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, zëri “Fondi i shpronësimeve”, për vitin 2016.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 800 000 (tetëqind mijë) lekë, të përballohen nga Ministria e Punëve të Jashtme.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, Ministria e Punëve të Jashtme, në bashkëpunim me Zyren Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, të kryejnë regjistrimin e pasurisë së cituar në pikën 1, në favor të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

8. Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

DATA BASE E PRONAREVE DHE MASA E SHPERBLIMIT PER PASURITE E PALUAJTSHME

TE DHENAT E PRONARIT DHE TE PASURISE SE PALUAJTSHME (sipas konfirmimit te ZVRPP-se)										TE DHENAT E POSEDUESIT										TE DHENAT PER SHPERBLIMIT			
NR.	EMER	ATESI	MBIEMER	STATUSI JURIDIK			SIP. E PRONES SIPAS HARTES VEKTOR (m²)	ZONA KADASTRALE	NUMRI PASURISE	NR. I SUBJEKTEVE	EMER	ATESI	MBIEMER	NUMRI PASURISE	SIPERFACIA E PARCELES QE ESHTE BERE KALIM PRONESIE (m2)	Mbledhje per Kalim Pronesie me VONI Nr. dt.	Data e Miratimit	SIPERFACIA TAKSISE PER KONFESIM	VENDODHJA E PASURISE (ZONA KADASTRALE)	VLERE E TREGUT PER TRUALL (qelbim)	VLERE E SHPERBLIMIT (lek)		
				NR. PROTOKOLLIT	DATE E LESIMIT	SIPERFACIA E PRONES (m²)																	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	19	20	21	22	23	24		
1	LLAQI	LLUK	ÇETRI	19944/1	18.11.2014	12877.61	12877.6	8250	1/944	1	AMBASADA E REPUBLIKES POPULLORE TE KINES				9000	67	28.01.2015	5440.3	8250	23,955	130,322,387		
2	LLAQI	LLUK	ÇETRI	10248/2	14.07.2015	2440.19	2440.19	8250	1/946	1	AMBASADA E REPUBLIKES POPULLORE TE KINES				9000	67	28.01.2016	2001.2	8250	23,955	47,938,746		
3	AGIM FATIKA NADIRE NIMETE SHPETIM	ISLAM MIHAL ISLAM SELMAN	PAJA QINAMI SHEHU DEVAJA QINAMI	10248/2	14.07.2015	761.32	761.32	8250	1/947	1	AMBASADA E REPUBLIKES POPULLORE TE KINES				9000	67	28.01.2015	708.6	8250	23,955	16,974,513		
3	AGIM FATIKA NADIRE NIMETE SHPETIM	ISLAM MIHAL ISLAM SELMAN	PAJA QINAMI SHEHU DEVAJA QINAMI	10248/2	14.07.2015	78.7	78.7	8250	1/160	1	AMBASADA E REPUBLIKES POPULLORE TE KINES				9000	67	28.01.2015	73.7	8250	23,955	1,765,483.5		
																		8223.8			197001129.50		
																		SIP. TOTALE (LEKE)			VLERE TOTALE (LEKE)		

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 140 lekë